



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovec/Municipality of Rahovec

---

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 01/128 Nr. i faq/Br.str/No.pg 86  
Data/Datum/Date 24.03.2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

1. **JEPET PËLQIMI** paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, personave fizikë dhe juridikë, deri në 40 (dyzet) vjet, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, përmes procedurës së shprehjes së interesit.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-09038-3 në sipërfaqe të përgjithshme prej 3399m<sup>2</sup> (tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë metra katror) duke përfshirë edhe objektin brenda kësaj prone, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe t'u jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë 2,200.00€ (dy mijë e dyqind euro) në vit.
5. Realizimi i pagesës së qirasë do të fillojë 24 (njëzet e katër) muaj pas nënshkrimit të kontratës në mes të qiradhënësit dhe të qiramarrësit.
6. Lejohet ndërtimi i etazhitetit të objektit sipas dokumenteve strategjike komunale, respektivisht Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit.
7. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 2 të këtij vendimi nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

8. Objektet përcjellëse dhe investimet e tjera në këtë pronë, pas mbarimit të afatit të dhënies në shfrytëzim të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do t'i kalojnë në pronësi Komunës së Rahovecit.
9. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZhK) 2023 – 2031, me nr. prot. 01 Nr. 182/24, të datës 30.1.2024, gjendet brenda zonës ndërtimore.
10. **OBLIGOHET** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, të zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur përmes shprehjes së interesit, konform Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01-Nr.128/26  
Më datë:24.03.2026

